

Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën

13 Dhjetor 2016

Ceremonia e Diplomimit 2016

Më 13 Dhjetor 2016, në ambjentet e “Albanian Star Hotel” të Kompleksit “Harmonia Hotels-Group”, Golem, në kuadër të aktiviteteve për 10-vjetorin e themelimit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, u mbajt Ceremonia e Diplomimit e studentëve të Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP). Kjo ceremoni u hap me fjalën përshëndetëse të Rektores së Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, Prof.Dr.Kseanela Sotirofski e cila i uroi mirëseardhjen të ftuarve të pranishëm në ceremoni dhe u drejtoi përgëzime të përzemërta diplomantëve të 2016-ës.

Kjo ceremoni, këtë vit, pati një dinamikë ndryshe pasi Senati Akademik i Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës me propozim të FASTIP vendosi që në këtë 10-vjetor, t’i akordojë titullin e nderit "Doctor Honoris Causa", Drejtorit të Përgjithshëm dhe Anëtar Bordi të Bankës Kombëtare Tregtare (BKT), z Pencabligil me motivacionin:

“Promotor i jashtëzakonshëm dhe mbështetës kryesor i idesë së implementimit të studimeve universitare duale në Shqipëri, kontributor për fillësën e veprimtarisë akademike të FASTIP që kur themelimi i tij ishte ende një ide, bankier që ka dhënë ndihmesë të vyer në përgatitjen e profesionistëve të orientuar në praktikë, bankierëve të ardhshëm të Shqipërisë”.



Ceremonia vijoi me përshëndetjet e të ftuarve të nderit, z.Prefekt të Qarkut Durrës, dhe të z.Pencabligil. Ky i fundit shprehu falenderimet e tij dhe theksoi se u ndje i nderuar nga titulli i akorduar. Në emër të bashkëudhëtarëve të tyre përshëndetën edhe tre diplomantë të secilit program studimi. Ceremonia përfundoi menjëherë pasi Rektoria e UAMD, Prof. Dr. Kseanela Sotirofski, citoi formulën e diplomimit duke i shpallur kështu zyrtarisht të diplomuar studentët e FASTIP të cilët nën tingujt e muzikës hodhën kapelet si simbol të përfundimit të viteve të tyre të studimit pranë FASTIP.

